

**MBI**  
**AUDITIMIN E USHTRUAR NË**  
**KOMUNËN BËRXULL TIRANË**

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Komunën Bërxull Tiranë**, me objekt: “Për auditimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë, vlerësimit financiar dhe menaxhimit e administrimit e asetëve të qëndrueshme etj.”, lloji i auditimit: “Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2011 deri 30.06.2014 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 153, datë 11.11.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 672/7, datë 11.11.2014, i ka rekomanduar z. Ymer Marku, Kryetar i Komunës Bërxull Tiranë, zbatimin e masave të mëposhtme:

### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetjet nga auditimi:** Nuk janë zbatuar të gjitha detyrat e lëna nga auditimi i mëparshëm i ushtruar nga KLSH, veprim në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit" ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1.6.2000.

**Rekomandimi:** Zyra e Financës në bashkëpunim me zyrat e tjera të Komunës, të marr të gjitha masat për arkëtimin dhe kontabilizimin e detyrimeve të prapambetura, të lënë nga auditimi i mëparshëm i KLSH, në vlerën **3,030,702** lekë.

**Brenda datës 30.03. 2015**

**2. Gjetjet nga auditimi:** Nuk është plotësuar e dërguar në Ministrinë e Financave, Drejtorinë e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, “PyetëSORIN e vetë-vlerësimit për raportimin vjetor rreth gjendjes së sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në institucionet publike”, veprim në kundërshtim me nenin 66, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për Menaxhimit e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimit Financiar dhe Kontrollin”.

**Rekomandimi:** Komuna Bërxull të dërgoj në Ministrinë e Financave, Drejtorinë e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar “PyetëSORIN e vetë-vlerësimit për raportimin vjetor rreth gjendjes së sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në institucionet publike”.

**Në vijimësi**

**3. Gjetjet nga auditimi:** Rregullorja e brendshme “Për kompetencat e Administratës së Komunës” nuk parashikon Kontrollin e Brendshëm Financiar, Funksionin e Auditimit të Brendshëm si strukturë më vete dhe si shërbim i kontraktuar, Koordinatorin e Riskut. Nuk parashikon krijimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GSM), nuk përcakton Strategjitë afatmesme të menaxhimit të risqeve që pengojnë realizimin e objektivave kryesore në hartimin e Planit të Buxhetit Afatmesëm, veprim në kundërshtim me nenet 19, 20, 21, 22, 27 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimit Financiar dhe Kontrollin”, nenin 66, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimit e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe Urdhrit të Kryeministrit nr. 78, datë 08.05.2006 “Mbi Krijimin e Grupeve për Strategji, Buxhet dhe Integrim”.

**Rekomandimi:** Komuna Berxull të marr masa që në Rregulloren e brendshme “Për kompetencat e Administratës së Komunës”, të parashikohet Kontrolli i Brendshëm Financiar dhe Koordinatori i Riskut. Të krijojë Grupin e Menaxhimit Strategjik (GSM) dhe Strategjinë e menaxhimit të risqeve për realizimin e objektivave kryesore në hartimin e Planit të Buxhetit Afatmesëm.

**Deri më datën 30.01.2015**

**4. Gjetjet nga auditimi:** Projektbuxheti dhe buxheti faktik për vitin 2011, 2012, 2013, 2014, nuk është hartuar dhe miratuar në këshillin e komunës, veprim në kundërshtim me pikën 8 neni 19, nenin 32 e 33, të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin e funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar dhe me nenin 17, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.

**Rekomandimi:** Zyra e Financës në Komunën Berxull të marr masa, të hartoj dhe miratoj në këshillin e komunës projekt buxhetin e vitit 2015 dhe të miratojë buxhetin faktik të vitit 2014.

**Deri më datën 30.11.2014**

**5. Gjetjet nga auditimi:** Fondin rezervë dhe fondin e kontigjencës për vitin 2011, 2012, 2013, 2014, nuk është llogaritur deri në masën 3 % të vlerës së përgjithshme të fondeve të miratuara, veprim në kundërshtim me nenin 6, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008.

**Rekomandimi:** Zyra e Financës në Komunën Berxull të marr masa dhe të miratoj fondin rezervë dhe fondin e kontigjencës deri në masën 3 % të vlerës së përgjithshme të fondeve të miratuara.

**Në vijimësi**

**6. Gjetjet nga auditimi:** Planifikimi i shpenzimeve operative për buxhetin e vitit 2011, 2012, 2013 e 2014, është planifikuar me rezervë, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008.

**Rekomandimi:** Zyra e Financës në Komunën Berxull të marr masa që planifikimin e shpenzimeve operative ta planifikoj pa rezerva dhe real, me qëllim që të pasqyrohen më saktë treguesit e planit të buxhetit të komunës.

**Në vijimësi**

**7. Gjetjet nga auditimi:** Dosjet e familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike për periudhën janar 2011 deri me 30.06.2014, nuk janë plotësuar me dokumentacion të plotë, veprim në kundërshtim me pikën 2, të VKM nr. 787, datë 14.12.2005 “Për përcaktimin e kriterëve të procedurave dhe masës së ndihmës ekonomike”, të ndryshuar dhe Udhëzimin MPÇS nr. 338/3, datë 10.3.2006 mbi zbatimin e VKM nr. 787, datë 14.12.2005 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike”.

**Rekomandimi:** Zyra e Ndihmës Ekonomike në Komunën Berxull të marr masa dhe të plotësojë me dokumentacion të plotë dosjet e familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike.

**Deri më datën 30.11.2014**

**8. Gjetjet nga auditimi:** Nuk është mbajtur ditari i magazinës, nuk janë pasqyruar veprimet që lidhen me dokumentimin e lëvizjen e aktiveve, hyrjet e materialeve dhe të inventarit, daljet nga përdorimi, që bilancet të mos pasqyrojnë gjendjen reale dhe të besueshme të pasurisë së komunës, veprim në kundërshtim me nenin 17, të ligjit nr. 9228, datë 24.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare”, nenin 12, të ligjit

nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

**Rekomandimi:** Zyra e Financës në komunën Berxull të marr masa dhe të mbaj ditarin e magazinës duke pasqyruar veprimet që lidhen me lëvizjen e aktiveve, me hyrjet e materialeve dhe të inventarit dhe daljet nga përdorimi.

**Deri më datën 30.11.2014**

**9. Gjetjet nga auditimi:** Arka është vendosur në një zyrë të pasigurt me mure betonarme, por në një ndërtime me elemente druri dhe plastike. Kasaforta që mbanë mjetet monetare nuk është e betonuar dhe e siguruar me element hekuri. Në arkë janë mbajtur mjete monetare më shumë se kufiri i lejuar ligjor, ndërsa arkëtimet nuk derdhen çdo ditë në Bankë, veprim në kundërshtim me pikën 3, të VKM nr. 290, datë 14.06.1993 “Për limitin e arkës në ndërmarrjet shtetërore” dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve të njësisë së sektorit publik”.

**Rekomandimi:** Drejtuesit e Komunës të marrin masa që arka të vendoset në një zyrë të siguruar me mure betoni, kasaforta që mban mjetet monetare të betonohet dhe të sigurohet me elemente hekuri. Në arkë të mos mbahen mjete monetare më shumë se kufiri i lejuar ligjor, ndërsa mjetet monetare të derdhen çdo ditë në Bankë.

**Deri më datën 30.12.2014**

**10. Gjetjet nga auditimi:** Në procedurën e prokurimeve me vlera të vogla mungon licenca e operatorit ekonomik në fushën e ndërtimit dhe tregtisë. Në fillim të vitit kalendarik prokurimi i materialeve nuk është planifikuar sipas natyrës, sasisë dhe llojit të kontratave, nuk është përcaktuar kufirin monetar për grup mallrash apo shërbimesh të ngjashme, të cilat prokurohen njëherësh dhe që nuk duhet të ndahen gjatë procedurës, veprim në kundërshtim me pikën 2, Kreu VI, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**Rekomandimi:** Zyra e Financës në komunën Berxull të marr masa dhe të kërkojë që operatorët ekonomikë të pajisen me licencë në fushën e ndërtimit dhe tregtisë. Në fillim të vitit kalendarik, prokurimi i materialeve të bëhet sipas natyrës, sasisë dhe llojit të kontratave, të përcaktohet kufirin monetar për grup mallrash apo shërbimesh të ngjashme, të cilat prokurohen njëherësh dhe të mos bëhet ndarja gjatë procedurës. Nga anëtarët e komisionit të nënshkruhen Fatura tatimore për prokurimet e kryera.

**Në vijimësi**

**11. Gjetjet nga auditimi:** Zyra e Financës në Komunën Berxull nuk i ka dërguar për regjistrim në ZVRPP Tiranë pasuritë e transferuara sipas VKM nr. 738, datë 18.05.2006 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyjeve, dhe kullotave, që do të transferohen në pronësi të njësisë vendore, komuna Berxull të Qarkut të Tiranës”, nuk ka bërë rivlerësimin e tyre dhe nuk i ka paraqitur në Pasqyrat Financiare të vitit 2011, 2012, 2013, veprim në kundërshtim me UMF. 30 datë “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

**Rekomandimi:** Zyra e Financës në komunën Berxull të marr masa, që pasuritë e transferuara sipas VKM nr. 738, datë 18.05.2006 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyjeve, dhe kullotave, që do të transferohen në pronësi të njësisë vendore, komuna Berxull të Qarkut të Tiranës”, ti dërgojë për regjistrim në ZVRPP Tiranë, të bëjë rivlerësimin e tyre dhe ti paraqesë në Pasqyrat Financiare të vitit 2014.

**Deri më datën 30.03.2015**

**12. Gjetjet nga auditimi:** Zyra e Financës në Komunën Berxull, materialet e nxjerra jashtë përdorimit nuk i ka bërë hyrje në magazinë, si dhe materialet që janë marrë nga

magazina për asgjësim nga magazinë nuk janë marrë me fletë dalje nga komisioni përkatës, veprim në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe UMB nr. 1151, datë 16.07.2007 “Për kriteret dhe proceduarat e vlerësimit dhe asgjësimit të aktiveve të qëndrueshme dhe qarkulluese në sistemin e Ministrisë së Brendshme”.

**Rekomandimi:** Zyra e Financës në komunën Berxull të marr masa, që materialet e nxjerra jashtë përdorimit të bëhen hyrje në magazinë, si dhe materialet që do të asgjësohen të merren nga komisioni i asgjësimit me fletë dalje.

**Në vijimësi**

**13. Gjetjet nga auditimi:** Zyra e Financës nuk ka marrë masa dhe nuk ka arkëtuar detyrimet debitore nga 7 persona në shumën **116,124 lekë**, detyrime të krijuar gjatë viti 2011, 2012, 2013, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 24.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare”, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël” dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

**Rekomandimi:** Zyra e Financës në komunën Berxull të marr masa dhe të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i shumës **116,124 lekë**, nga personat përkatës që janë debitorë.

**Brenda datës 30.03. 2015**

**14. Gjetjet nga auditimi:** Nga Zyra e Financës nuk janë regjistruar në librat e kontabilitetit dhe nuk janë paraqitur në Pasqyrat Financiare të vitit 2011, 2012, 2013, detyrimet e pa shlyera të ujit të pijshëm për: shkolla e Re, shkolla e Vjetër, kopshti i fëmijëve Domje dhe qendra shëndetësore Domje në shumën **1,187,428 lekë**, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 24.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare”, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël” dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

**Rekomandimi:** Zyra e Financës në komunën Berxull të marr masa dhe në miratimin e buxhetit të vitit 2015 të planifikojë dhe miratojë pagesën e ujit të pijshëm për shkolla e Re, shkolla e Vjetër, kopshti dhe qendra shëndetësore në shumën **1,187,428 lekë** dhe të paraqes në Pasqyrat Financiare të vitit 2014.

**Brenda datës 30.03. 2015**

**15. Gjetjet nga auditimi:** Zyra e Financës në Komunën Berxull nuk ka regjistruar në librat e kontabilitetit dhe në pasqyrat financiare të vitit 2011, 2012, 2013, familjet debitor të fshatit Domje dhe Berxull, të cilat nuk kanë paguar ujin e pijshëm në shumën **3,540,336 lekë**, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 24.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare”, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël” dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

**Rekomandimi:** Zyra e Financës në komunën Berxull të marr masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e shumës **3,540,336 lekë**, pagesa të pa arkëtuar për ujin e pijshëm nga familjet e fshatit Domje dhe Berxull dhe ti paraqes në pasqyrat financiare të vitit 2014, sipas pasqyrës bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**Brenda datës 30.03. 2015**

**16. Gjetjet nga auditimi:** Nuk janë të arshivuara dosjet e objekteve dhe subjekteve ndërtuese, që kanë marrë lejen e Përdorimit dhe kanë kaluar për regjistrim në ZRPP,

veprim në kundërshtim me nenin 24, germa b, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat” si dhe të nenit 4 dhe 5 kapitulli II mbi “Detyrat e sekretarit-arkivit të organit të organit shtetërorë” të “Rregullores për punën me dokumentet administrative të organeve shtetërore”.

**Rekomandimi:** Zyra e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban dhe INUV, për çdo dosje, të sistemohet dhe të inventarizohet dokumentacioni dhe të dorëzojë në zyrën e arkivit të komunës, të gjitha dosjet e subjekteve ndërtuese, që kanë marrë lejen e Përdorimit dhe kanë kaluar për regjistrim në ZRPP.

**Brenda datës 30.03. 2015**

**17. Gjetjet nga auditimi:** Janë miratuar leje ndërtimi dhe leje përdorimi, me mungesa në dokumentacionin tekniko ligjorë dhe pa raportin e mbikëqyrësit të punimeve, pasi nuk ka patur mbikëqyrës për ndjekjen e punimeve të ndërtimit, veprim në kundërshtim me nenin 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, me pikën 4, të udhëzimit nr. 3, datë 15.02.2001 “Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar me udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011.

**Rekomandimi:** Zyra e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban të marr masa që të gjithë punimet e ndërtimit të objekteve të kenë mbikëqyrësin e punimeve dhe të mos kalojë për miratim, asnjë leje përdorimi, që nuk ka të plotësuar dokumentacionin teknik ligjorë dhe të mos pranohet dhe të mos shqyrtohet kërkesa për leje përdorimi për subjektet ndërtuese dhe investitorët, pa pasur më parë një vërtetim nga Zyra e Financës, që të vërtetojë shlyerjen e të gjitha detyrimeve financiare.

**Në vijimësi**

**18. Gjetjet nga auditimi:** Nuk është krijuar Regjistri Planifikimit të Territorit, ku të pasqyrohen të gjithë të dhenat përkatëse lidhur me zhvillimin e territorit që administrojnë, veprim në kundërshtim me pikën 4, neni 53, të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”, të ndryshuar.

**Rekomandimi:** Zyra e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban të regjistroj të dhëna përkatëse, duke krijuar regjistrin e planifikimit të territorit, për territorin që administrohet nga komuna.

**Në vijimësi**

**19. Gjetjet nga auditimi:** Nuk ka një kontroll të vazhdueshëm lidhur me zhvillimin e territorit dhe zbatimin e instrumentave të planifikimit të territorit për shmangien e shkeljeve mjedisore dhe abuzimet me territorin, veprim në kundërshtim me pikën 1, neni 80, të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”, të ndryshuar.

**Rekomandimi:** Zyra e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban të ushtrojë vazhdimisht kompetencat në lidhje me kontrollin e zhvillimit të territorit, për zbatimin e instrumentave të planifikimit dhe të marr masat përkatëse për të shmangur shkeljet mjedisore dhe abuzimet me territorin.

**Në vijimësi**

**20. Gjetjet nga auditimi:** Nuk ka një bashkëpunim ndërmjet autoriteteve të planifikimit, duke mos bashkërenduar veprimet ndërmjet tyre dhe nuk ka shkëmbim informacioni, veprim në kundërshtim me pikën 2, neni 80, të ligjit nr.10119 “Për Planifikimin e Territorit”, i ndryshuar.

**Rekomandimi:** Zyra e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban të rrisë bashkëpunimin me strukturat e tjera brenda komunës dhe me autoritet e tjera të

planifikimit të çdo niveli duke shkëmbyer informacion për gjendjen e planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit.

#### **Në vijimësi**

**21. Gjetjet nga auditimi:** Nuk ka një raportim të rregullt për gjendjen e planifikimit dhe të kontrollit të zhvillimit të territorit dhe nuk kanë përgatitur raporte vjetore për zhvillimet në territor të vitit të mëparshëm, veprim në kundërshtim me pikën 3, neni 80, të ligjit nr. 10119 “Për Planifikimin e Territorit”, i ndryshuar.

**Rekomandimi:** Zyra e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban të raportojë rregullisht për gjendjen e planifikimit dhe të përgatisë raporte vjetore për zhvillimet në territor të vitit të mëparshëm.

#### **Në vijimësi**

**22. Gjetjet nga auditimi:** Nuk janë ndjekur procedurat dhe hapat ligjorë, për të bërë të mundur arkëtimin e gjobave të vendosura nga INUV-i, në vlerën 3,064,463 lekë, veprim në kundërshtim me nenin 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “ Për Kontrollin dhe disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar dhe me nenin 22, me pikën 4/a të nenit 30, të ligjit nr. 10279, “Për Kundërvajtjet Administrative”.

**Rekomandimi:** Inspektorati Ndërtimor Urbanistik në bashkëpunim me Zyrën Juridike të ndërmarrë të gjitha hapat ligjorë për të dërguar në “Shërbimin Përmbarimorë” urdhër ekzekutimet e vendim gjobave, për të bërë të mundur arkëtimin e gjobave që nuk janë arkëtuar.

#### **Në vijimësi**

**23. Gjetjet nga auditimi:** Nuk janë ushtuar kontrole në të gjithë territorin e komunës dhe nuk janë kontrolluar subjektet që ndërtojnë objekte të paisura me leje ndërtimi, veprim në kundërshtim me nenin 5, të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2011 “Për Inspektimin e ndërtimit”, i ndryshuar.

**Rekomandimi:** Inspektorati Ndërtimor Urbanistik të marr masa që për objektet e pajisura me leje ndërtimi, të respektohet zbatimi i tyre sipas kushteve të lejes dhe të parandalojë zhvillimet e paligjshme në territorin e komunës.

#### **Në vijimësi**

**24. Gjetjet nga auditimi:** Nuk janë hartuar regjistrat elektronikë, për të mundësuar regjistrimin e akteve të nxjerra, veçanërisht aktet e vendim gjobave veprim në kundërshtim me pikën 4, të nenit 81, të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “ Për Planifikimin e Territorit” dhe me pikën 19 “Detyrat” të Rregullores së brendshme të komunës.

**Rekomandimi:** Inspektorati Ndërtimor Urbanistik të marr masa që të hartojë regjistrat përkatës elektronikë, për të bërë të mundur regjistrimin e akteve të nxjerra, në veçanti për aktet e vendim gjobave.

#### **Menjëherë**

**25. Gjetjet nga auditimi:** Dokumentet e konstatimit të mbajtur nga punonjësit e INUV-it , nuk janë në përputhje me dokumentin specifik të miratuar, veprim në kundërshtim me pikën 4, të VKM nr. 862, datë 05.12.2007 “Për Unifikimin e Procedurave të Kontrollit të Territorit nga Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar e ai Vendor”.

**Rekomandimi:** Inspektorati Ndërtimor Urbanistik të marr masa që dokumentacioni i konstatimit të plotësohet sipas formatit ligjor të përcaktuar, ku fletët kanë numër serie dhe është dokument specifik i miratuar.

#### **Menjëherë**

**26. Gjetjet nga auditimi:** Nuk ka një bashkëpunim produktiv të INUV-it, me strukturat e tjera brenda komunës dhe me autoritet e tjera të kontrollit të territorit të çdo niveli, duke mos shkëmbyer informacion për gjendjen e planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit, veprim në kundërshtim me pikën 3, të nenit 81, të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “ Për Planifikimin e Territorit”, i ndryshuar.

**Rekomandimi:** Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Vendor, të rrisë efektivitetin e punës, duke bashkëpunuar me strukturat e tjera brenda komunës dhe me autoritetet e tjera të kontrollit të territorit të çdo niveli, duke shkëmbyer informacion për gjendjen e planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit.

#### **Menjëherë**

**27. Gjetjet nga auditimi:** Nuk është bërë planifikimi real i të ardhurave, nuk është mbajtur regjistri themelor sipas kategorive të subjekteve taksa pages, nuk janë hartuar plane pune për ushtrimin e kontrolleve në subjekt, si dhe nuk janë njoftuar subjektet lidhur me shlyerjen e detyrimeve, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9236, datë 30.10.2006 “Për taksat dhe tatimet vendore”.

**Rekomandimi:** Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për:

a. Planifikimin real të taksave e tarifave vendore, bazuar në të dhënat që disponon Komuna dhe realizimeve të mëparshme, duke i programuar ato analitikisht, në mënyrë që niveli i planifikimit të tyre të vijë në rritje nga njëra periudhë në tjetrën.

b. Hartimin e regjistrit themelor të subjekteve fizik, juridik dhe abonentëve familjarë, për taksën/tarifën e biznesit, tokës bujqësore, ndërtesës, pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit.

c. Hartimin e planeve mujore dhe vjetore për ushtrimin e kontrolleve në përputhje me pikën 10 “Kontrolli tatimor”, të udhëzimit të përbashkët të MB dhe MF nr. 655/1, datë 06.02.2007.

d. Njoftimin e të gjithë abonentëve familjarë dhe jo familjarë, mbi detyrimet që ato kanë për taksat/tarifat vendore në zbatim të nenin 4, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 dhe nenin 32, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008.

#### **Në Vijimësi**

**28. Gjetjet nga auditimi:** Nuk është rakorduar e nuk është kërkuar nga institucionet e tjera që veprojnë si agjente tatimore dhe nuk është kërkuar prej tyre rakordimi i vlerave.

**Rekomandimi:** Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore të marr masa për një ndjekje dhe arkëtim të taksave që mblidhen nga njësitë e tjera publike (*D.P.SH.T.Rr Tiranë, ZVRPP Tiranë*) etj, duke kërkuar e bërë rakordime periodike dhe ushtrimin e të drejtës ligjore për të ndikuar mbi agjentët tatimor, të cilët duhet të sjellin ndryshime në rritje për treguesit e planifikimit, realizimit në fakt të të ardhurave.

#### **Në Vijimësi**

**29. Gjetjet nga auditimi:** Nga mosfunksionimi i duhur i Zyrës së Taksave e Tarifave Vendore janë krijuar subjekte debitorë në vlerën prej 3,533 mijë lekë.

**Rekomandimi:** Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Zyrën e Financës, të marrin masa për kërkimin në rrugë administrative e ligjore arkëtimin e debitorëve për 60 raste me një vlerë prej **3,533 mijë lekë**.

#### **Menjëherë**

**30. Gjetjet nga auditimi:** Nga mosfunksionimi i duhur i Zyrës së Taksave e Tarifave Vendore, lidhur me arkëtimin e subjekteve debitorë në 60 raste në vlerën prej 3,533 mijë lekë dhe mos llogaritja e penaliteteve në masën prej 25%, janë krijuar të ardhura të munguara në vlerën prej **883 mijë lekë**.

**Rekomandimi:** Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore të marr masa që të kontabilizohet dhe të kërkohet në rrugë administrative e ligjore arkëtimi i gjobës në masën 25 % të detyrimit të papaguar në afate ligjore, për vlerën **883,450 lekë**.

**Menjëherë**

**31. Gjetjet nga auditimi:** Nga mosfunksionimi i duhur i Zyrës së Taksave e Tarifave Vendore nuk është bërë i mundur evidentimi i plotë i të gjithë subjekteve debitorë për periudhën 2011-2013 dhe nuk është bërë regjistrimi i tyre në pasqyrat financiare të komunës, në zbatim të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 dhe VKM nr. 783, datë 22.11.2006, Kap I, -Mbjajta e kontabilitetit, pika 2, germa (c), -Dokumentet e kontabilitetit, pika 2.3 -Rregullat e përgjithshme të mbajtjes së librave dhe dokumenteve të tjera të kontabilitetit.

**Rekomandimi:** Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore të marr masa për evidentimin, saktësimin e subjekteve debitorë në fund të periudhave ushtrimore dhe përcjellja e tyre në Zyrën e Financës, me qëllim pasqyrimin e tyre në pasqyrat financiare të Komunës Bërxull dhe ndjekjen në vazhdimësi.

**Menjëherë**

**32. Gjetjet nga auditimi:** Nga mosbashkëpunimi i Zyrës së Taksave e Tarifave Vendore me Drejtorinë Rajonale Tatimore janë lejuar funksionimi i 708 subjekteve tregtare të pa regjistruara në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, ku referuar pagës minimale mbi të cilën llogaritet vlera e kontributeve për sigurimet shoqërore e shëndetësore, detyrimi i munguar për llogaritet për afërsisht për një vlerë prej 11,658,636 lekë {5,489 lekë në muaj x 12 muaj x 3 vjet periudhë auditimi (2012-2014) x 59 subjekte}, e cila konsiderohet me efekte financiare negative në të ardhurat e buxhetit të shtetit.

**Rekomandimi:** Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore të bashkëpunoj me Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Tiranë për regjistrimin në QKR të 708 subjekteve, të cilat ushtrojnë aktivitet tregtar duke mos ju nënshtruar detyrimeve për kontributin e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore.

**Menjëherë**

**33. Gjetjet nga auditimi:** Zyra e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës ka dërguar për regjistrim në ZVRPP Tiranë dhe në Këshillin e Qarkut Tiranë, Aktet e Marrjes së Tokës në Pronësi, pa disponuar asnjë dokumentacion mbi familjet bujqësore që kanë përfituar tokë, përveç regjistrimit të gjendjes civile, i cili nuk është dokument i mjaftueshëm për këtë proces.

**Rekomandimi:** Zyra e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës të mbaj regjistrin e tokës bujqësore (tokën bujqësore të ndarë, numrin e familjeve bujqësore përfituese, sipërfaqen e përfitimit, zërin kadastral të saj, etj), si dhe të kërkohet nga Qarku Tiranë DAMT dhe ZVRPP Tiranë:

- kopje të njësuar me origjinalin e formularit nr. 6,
- kopje të njësuar me origjinalin e Regjistrave Kadastral të tokës bujqësore të vitit 1991 apo 1992,
- kopje të njësuar me origjinalin e hartave kadastrale, të shërbyer për procesin e ndarjes së tokës,
- kopje të njësuar me origjinalin e librave të ngastrave,
- kopje të njësuar me origjinalin e Hartave Treguese të Regjistrimit të ZVRPP.

**Në Vijimësi**

**34. Gjetjet nga auditimi:** Si pasojë e mosrakordimit nga Zyra e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës me atë të Taksave e Tarifave Vendore janë konstatuar mjaft raste



të dërgimit për regjistrim të AMTP, ku subjektet përfituese nuk figurojnë të kenë paguar taksat mbi tokën bujqësore apo kanë paguar për një sipërfaqe më të vogël se ajo e disponuar në AMTP. Nga auditimi rezultuan se në 21 raste AMTP e dërguar për regjistrim nuk figuronte e pasqyruar në regjistrin e taksave për tokën bujqësore, pra këtyre subjekteve nuk ju është përlogaritur taksa e tokës e për rrjedhojë nuk është paguar ajo, taksë e cila nisur nga sipërfaqja sipas AMTP dhe çmimi për ha në vit për 3 vite është 296,000 lekë dëm ekonomik për buxhetin e komunës.

**Rekomandimi:** Zyra e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës të marr masa që për çdo rast të konfirmimit të AMTP dhe dërgimit për regjistrim në ZVRPP, më parë të rakordohet dhe merret konfirmim shkresor nga Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore në Komunë lidhur me detyrimet e pashlyera të përfaqësuesit të familjes bujqësore mbi pagesën e taksës për tokën.

#### **Në Vijimësi**

**35. Gjetjet nga auditimi:** Me kontratën datë 09.09.2013, lidhur ndërmjet Drejtorisë së Shërbimeve Tregtare në Ministrinë e Bujqësisë dhe shoqërisë “Ch...Farm” sh.a. mbi dhënien me qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit, me sipërfaqe 39.52 ha, rezulton se në parcelën nr. 74 janë regjistruar 3000 m<sup>2</sup> truall. Në Kontratën e lidhur ndërmjet palëve, trualli me sipërfaqe 3000 m<sup>2</sup> nuk është llogaritur sipas VKM nr. 529, datë 08.06.2011 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, por është llogaritur sipas VKM nr. 460, datë 22.5.2013 “Për përcaktimin e kritereve, rregullave dhe procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”, duke shkaktuar një dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në shumën **3,600,000 lekë në vit.**

**Rekomandimi:** Komuna Berxull të njoftojë Ministrinë e Bujqësisë, për pasaktësinë e kontratës së lidhur në favor të “Ch.F.” sh.a., për truallin me sipërfaqe prej 3000 m<sup>2</sup>, duke krijuar dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në shumën **3,600 mijë lekë në vit.**

#### **Menjëherë**

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

Mbështetur në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i ndryshuar, kreu IV, nenet 9-14, ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, kreu I, nenet 105-109 dhe udhëzimin e Ministrit të Financave, nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kap IV, Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësit Autorizues), të nxirren aktet administrative dhe (Nëpunësi zbatues), të kryejë kontabilizimet duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore, administrative dhe procedurat përbarimore me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në vlerën në vlerën **6,910,783 lekë**, si më poshtë:

**1. Gjetjet nga auditimi:** Në Komunën Berxull 3 punonjës të administratës kanë përfituar padrejtësisht pagë në shumën **156,913 lekë**, veprim në kundërshtim me VKM nr. 1619, datë 02.07.2008 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësisve të qeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore”, të ndryshuar.

**Rekomandimi:** Komuna Berxull të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **156,913 lekë**, sapërfitur tepër nga **3 punonjësit si më poshtë:**

- vlera 26,000 lekë, nga Sh.M.me detyrë ish-arkëtar për periudhën janar-shkurt 2011, paguar me pagën e arsimit të lartë në klasën IV-a.

- vlera 63,725 lekë, nga P.J. me detyrë Kryeinspektor i Inspektoratit Ndërtimore e Urbanistik, sipas Urdhrit të emërimit në punë është paguar 32 para fillimit të punës për periudhën 01-30 shtator 2011.

- në vlerën 67,188 lekë nga B.M. me detyrë arkivist dhe magazinier për periudhën 01.07.2013 deri me 30.06.2014, paguar me pagën e arsimit të lartë klasa e IV-a.

**Brenda datës 30.03. 2015**

**2-Gjetjet nga auditimi:** Në Komunën Berxull 13 anëtarët e këshilli të komunës për mospjesëmarrje në mbledhje të këshillit për muajin maj-qershor të vitit 2011, kanë përfitur padrejtësisht shumën **180,180 lekë**, veprim në kundërshtim me pikën 16, të VKM nr. 1619, datë 2.7.2008 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore”, të ndryshuar.

**Rekomandimi:** Komuna Berxull të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **180,180 lekë**, sa përfitur tepër nga **13 ish-anëtarët e këshillit.**

**Brenda datës 30.03. 2015**

**3. Gjetjet nga auditimi:** Komisioni i prokurimeve me vlera të vogla ka kryer shërbime me fadromë (15 orë pune x 3 037.<sup>70</sup> lekë/ora), të cila nuk janë në urdhrin e prokurimit nr. 8, datë 18.04.2012, të miratuar nga kryetari i komunës, duke paguar më tepër shumën **45,560 lekë**, veprim në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

**Rekomandimi:** Komuna Berxull të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **45,560 lekë**, sa paguar operatorin ekonomik në kundërshtim me urdhrin e prokurimit nr. 8, datë 18.04.2012, **si më poshtë:**

- vlera 15,187 lekë nga Z.V. me detyrë kryetare e komisionit të prokurimeve me vlera të vogla, sa paguar punime me fadromë të paparashikuara në kundërshtim me urdhrin e prokurimit nr. 8, datë 18.04.2012;

- vlera 15,187 lekë nga K.H. me detyrë anëtar i komisionit të prokurimeve me vlera të vogla, sa paguar punime me fadromë të paparashikuara në kundërshtim me urdhrin e prokurimit nr. 8, datë 18.04.2012;

- vlera 15,187 lekë nga N.B. me detyrë anëtar i komisionit të prokurimeve me vlera të vogla, sa paguar punime me fadromë të paparashikuara në kundërshtim me urdhrin e prokurimit nr. 8, datë 18.04.2012;

**Brenda datës 30.03. 2015**

**4. Gjetjet nga auditimi:** Komisioni i prokurimit me vlera të vogla nuk ka zbatuar kërkesat e pikës 6, të Kontratës datë 02.08.2012, për “Studimi Projektimi i objektit “Sistemim asfaltimi i rrugës Rinas-Lagja Sefa””, duke paguar më tepër shumën **66,600 lekë**, veprim në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve të njësisë së sektorit publik” dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

**Rekomandimi:** Komuna Berxull të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **66,600 lekë**, sa paguar operatorin ekonomik Bashkim Mata, në kundërshtim me pikën 6, të Kontratës datë 02.08.2012, për “”Studimi Projektimi i objektit “Sistemim asfaltimi i rrugës Rinas-Lagja Sefa””.

**Brenda datës 30.03. 2015**

**5. Gjetjet nga auditimi:** Komisioni i prokurimit me vlera të vogla ka paguar më tepër shumën **21,000 lekë** për transport mbeturinash, duke mos kontrolluar preventivin e punimeve, veprim në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve të njësisë së sektorit publik” dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

**Rekomandimi:** Komuna Berxull të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **21,000 lekë**, sa paguar më tepër operatorin ekonomik për transport mbeturinash, duke mos kontrolluar preventivin e punimeve, **si më poshtë:**

- vlera 7,000 lekë nga Z.V. me detyrë kryetare e komisionit të prokurimeve me vlera të vogla, sa paguar punime me fadromë të paparashikuara në kundërshtim me pikën 6, të Kontratës datë 02.08.2012, për Studimi Projektimi “Sistemim asfaltimi i rrugës Rinas-Lagja Sefa”;

- vlera 7,000 lekë nga K.H. me detyrë anëtar i komisionit të prokurimeve me vlera të vogla, sa paguar punime me fadromë të paparashikuara në kundërshtim me pikën 6, të Kontratës datë 02.08.2012, për Studimi Projektimi “Sistemim asfaltimi i rrugës Rinas-Lagja Sefa”;

- vlera 7,000 lekë nga N.B. me detyrë anëtar i komisionit të prokurimeve me vlera të vogla, sa paguar punime me fadromë të paparashikuara në kundërshtim me pikën 6, të Kontratës datë 02.08.2012, për Studimi Projektimi “Sistemim asfaltimi i rrugës Rinas-Lagja Sefa”;

**Brenda datës 30.03. 2015**

**6. Gjetjet nga auditimi:** Komisioni i emergjencës ka përcaktuar çmimin e autobotit që pastron gropat skeptike me 5280 lekë/ora. Pagesa është kryer pa preventiv punimesh, pa përcaktuar sasinë e gropave skeptike, sasinë e mbetjeve, volumin e kanaleve të zeza, numrin e pushtave që do të pastrohen dhe sasia e mbetjeve që mbajnë, nuk është hartuar grafiku ditorë i punës së kryer nga autoboti, nuk është përcaktuar vendi i depozitimit të mbetjeve që do të pastrojë, për rrjedhojë është paguar më tepër shuma **264,000 lekë**, veprim në kundërshtim me UMF nr. 30 datë “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe shkronjën “ç” pika 2, Kreu VI, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

**Rekomandimi:** Komuna Berxull të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **264,000 lekë**, sa paguar më tepër operatorin ekonomik për transport mbeturinash, duke mos kontrolluar preventivin e punimeve, **si më poshtë:**

- vlera 88,000 lekë nga N.B. me detyrë kryetar i komisionit të prokurimeve me vlera të vogla të emergjencës, sa paguar pastrimin e gropave skeptike pa preventiv, pa përcaktuar sasinë e gropave skeptike, sasinë e mbetjeve, distanca e kanaleve të zeza, volumin, numri i pushtave, sasia e mbetjeve, vendin e depozitimit të mbeturinave, pa hartuar grafiku ditorë për punën që ka kryer autoboti.

- vlera 88,000 lekë nga K.K. me detyrë anëtar i komisionit të prokurimeve me vlera të vogla të emergjencës, sa paguar pastrimin e gropave skeptike pa preventiv, pa përcaktuar sasinë e gropave skeptike, sasinë e mbetjeve, distanca e kanaleve të zeza, volumin, numri i pushtave, sasia e mbetjeve, vendin e depozitimit të mbeturinave, pa hartuar grafiku ditorë për punën që ka kryer autoboti.

- vlera 88,000 lekë nga K.H. me detyrë anëtar i komisionit të prokurimeve me vlera të vogla të emergjencës, sa paguar pastrimin e gropave skeptike pa preventiv, pa përcaktuar sasinë e gropave skeptike, sasinë e mbetjeve, distanca e kanaleve të zeza,

volumin, numri i pushtave, sasia e mbetjeve, vendin e depozitimit të mbeturinave, pa hartuar grafiku ditorë për punën që ka kryer autoboti.

**Brenda datës 30.03. 2015**

**7. Gjetjet nga auditimi:** Zyra e Financës në komunën Berxull ka paguar shpenzime transporti për Kryetarin e Komunës për muajin dhjetor 2013, janar dhe shkurt të vitit 2014, në shumën **60,000 lekë**, në kundërshtim me pikën 2, të ligjit nr. 169/2013, datë 07.11.2013 “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë”.

**Rekomandimi:** Komuna Berxull të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **60,000 lekë**, sa paguar më tepër shpenzime transporti për Kryetarin e Komunës z. Y. M. për periudhën dhjetor 2013, janar dhe shkurt të vitit 2014.

**Brenda datës 30.03. 2015**

**8. Gjetjet nga auditimi:** Për pajisjen me numër telefoni celulari për 11 punonjës të administratës, janë paguar nga llogaria e shpenzimeve operative të buxhetit të komunës në shumën **138,464 lekë**, në kundërshtim me pikën 11, Lidhja nr. 6, të VKM nr. 864, datë 23.07.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridik, publik”.

**Rekomandimi:** Komuna Berxull të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **138,464 lekë**, sa përfituar padrejtësisht nga pajisja me numër telefoni celulari për 11 punonjësit, për periudhën 2012-2013.

**Brenda datës 30.03.2015**

**9. Gjetjet nga auditimi:** Janë kryer pagesa të tepërta në vlerën **143,270 lekë** për situacionimin e punimeve të pa kryera në 6 zëra punimesh, në objektin “Ndërtim godine administrate, shtesë 1 kat, në komunën Berxullë”, në kundërshtim me kushtet e kontratës nr. 877, datë 19.02.2013.

**Rekomandimi:** Komuna Berxull të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **143,270 lekë**, nga OE “R..N..” sh.p.k. & “N...” sh.p.k., e përfituar padrejtësisht nga situacionimi i punimeve të pa kryera në objektin “Ndërtim godine administrate, shtesë 1 kat, në komunën Berxullë”.

**Brenda datës 31.01. 2015**

**10. Gjetjet nga auditimi:** Janë kryer pagesa të tepërta në vlerën **221,400 lekë**, për situacionimin e punimeve të pa kryera në 2 zëra punimesh, në objektin “Sistemim Asfaltim Rruga “Lagja e Kastriotëve””, në kundërshtim me kushtet e kontratës, datë 01.08.2011.

**Rekomandimi:** Komuna Berxull të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **221,400 lekë**, nga OE “A... C...” sh.p.k., paguar për situacionimin e punimeve të pa kryera në objektin “Sistemim Asfaltim Rruga “Lagja e Kastriotëve””.

**Brenda datës 31.01. 2015**

**11. Gjetjet nga auditimi:** Zyra e Urbanistikës në Komunën Berxull ka llogaritur më pak në shumën **3,633,616 lekë** taksat e urbanistikës për 8 subjekte për të cilat është miratuar vendimi për tu pajisur me leje ndërtimi dhe për 2 subjekte që kanë marrë leje përdorimi, veprim në kundërshtim me nenin 51, të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për Urbanistikën”, i ndryshuar, me nenin 27, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Taksat Vendore”, i ndryshuar dhe me Vendimin nr. 1, datë 02.02.2011 e nr. 1, datë 23.01.2012 “Për miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore për Vitin 2012” të Këshillit të Komunës.

**Rekomandimi:** Komuna Berxull të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **3,633,616 lekë nga 10 subjekte**, pasi janë paguar më pak detyrimet financiare të taksave të

urbanistikës, për 8 subjekte që janë paisur me leje ndërtimi dhe 2 subjekte që kanë marrë leje përdorimi, **si më poshtë:**

-investitori V.P. dhe subjekti ndërtues “A.-E..A” sh.p.k. vlerën **84,064** lekë, pasi ka paguar më pak detyrimet financiare për tu pajisur me leje ndërtimi sipas vendimit të KRRT-së, datë 18.03.2011, me objekt “banesë 2kat+podrum”,

-investitori “L. Konstruksion” dhe subjekti ndërtues “L...” sh.p.k. vlerën **498,496** lekë, pasi ka paguar më pak detyrimet financiare për tu pajisur me leje ndërtimi sipas vendimit të KRRT-së, datë 18.03.2011, me objekt “magazinë 2kat+ 3 kat zyra”,

- investitori “E... A.E.” dhe subjekti ndërtues “M...-B sh.p.k.” vlerën **96,465** lekë, pasi ka paguar më pak detyrimet financiare për tu pajisur me leje ndërtimi, sipas vendimit të KRRT-së, datë 21.03.2011, me objekt “magazinë 2kat”,

- investitori “D... Auto” dhe subjekti ndërtues “S.. 2006 sh.p.k.” vlerën **133,744** lekë, pasi ka paguar më pak detyrimet financiare për tu pajisur me leje ndërtimi sipas vendimit të KRRT-së, datë 18.03.2011, me objekt “magazinë 1 kat”,

- investitori “T..T shpk.” dhe subjekti ndërtues “2..H sh.p.k.” vlerën **444,580** lekë, pasi ka paguar më pak detyrimet financiare për tu pajisur me leje ndërtimi sipas vendimit të KRRT-së, datë 26.09.2011, me objekt “Kapanon industrial 1 kat+3kat zyra”,

- investitori “A...” dhe subjekti ndërtues “A... sh.p.k.” vlerën **1,613,633** lekë, pasi ka paguar më pak detyrimet financiare për tu pajisur me leje ndërtimi sipas vendimit të KRRT-së, datë 26.09.2011, me objekt “Fabrikë 2 kat”,

- investitori Xh.L. dhe subjekti ndërtues “T.. sh.p.k.” vlerën **284.008** lekë, pasi ka paguar më pak detyrimet financiare për tu pajisur me leje ndërtimi sipas vendimit të KRRT-së, datë 26.09.2011, me objekt “banesë 3 kat + podrum”,

- investitori “L... shpk.” dhe subjekti ndërtues “K... sh.p.k.” vlerën **191,349** lekë, pasi ka paguar më pak detyrimet financiare për tu pajisur me leje ndërtimi sipas vendimit të KRRT-së, datë 26.09.2011, me objekt “Kapanon industrial 2 kat”,

- investitori “S.P.” dhe subjekti ndërtues “E.. B..” sh.p.k. vlerën **162,150** lekë, pasi ka paguar më pak detyrimet financiare për tu pajisur me leje përdorimi nr. 561/1, datë 30.08.2012, me objekt “Godinë shërbimi 2 kat+1 kat podrum”,

- investitori “A.D.” dhe subjekt ndërtues “E...-AL” sh.p.k. vlerën **125,127** lekë, pasi ka paguar më pak detyrimet financiare për tu pajisur me leje përdorimi nr. 427/1, datë 13.06.2012, me objekt “Shtesë 1 kat”.

**Brenda datës 31.01. 2015**

**12. Gjetjet nga auditimi:** Si rezultat i mosllogaritjes, mosarkëtimit e mos kërkimit të taksave e tarifave për transport mallrash, udhëtarësh, tregtisë me pakicë, si dhe taksës mbi reklamën është krijuar dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore në vlerën prej **1,524 mijë lekë.**

**Rekomandimi:** Komuna Berxull të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **1,524,580 lekë.**

**Brenda datës 31.01. 2015**

**13. Gjetjet nga auditimi:** Për Taksën e Tokës Bujqësore, rezultoi se në 21 raste AMTP e dërguar për regjistrim nuk figuronin të pasqyruar në regjistrin e taksave për tokën bujqësore, pra këtyre subjekteve nuk ju është përllogaritur taksa e tokës, për rrjedhojë nuk është paguar ajo, taksë e cila nisur nga sipërfaqja sipas AMTP është  $16 \text{ ha} \times 5000 \text{ lekë/ha/vit} = 80,000 \text{ lekë} \times 3 \text{ vite} = 240,000 \text{ lekë}$ , ndërsa për vitin 2011 është  $16 \text{ ha} \times 3500 \text{ lekë/ha/vit} = 56000 \text{ lekë}$  dhe në total për të 4 vitet është **296,000 lekë.**

**Rekomandimi:** Komuna Berxull të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **296,000 lekë**, detyrimin për taksën e tokës bujqësore për 21 subjekte fermerë.

**Brenda datës 31.01. 2015**

**14. Gjetjet nga auditimi:** Si rezultat i mos aplikimit të detyrimeve për taksat e tarifave vendore nga njëra periudhë në tjetër, për 6 subjekte nuk është bërë i mundur aplikimi i detyrimeve me **vlerë 159,200 lekë**, si dëm ekonomik në të ardhurat e munguara në buxhetin e komunës.

**Rekomandimi:** Komuna Berxull të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **159,200 lekë**, si detyrim i pataksuara për 6 subjekte të cilët kanë qenë aktiv në vitin 2012 por nuk ju është llogaritur detyrimi.

**Brenda datës 31.01. 2015**

### **C. MASA DISIPLINORE**

**C.I. Mbështetur në nenin 37 dhe 154, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës”, të ndryshuar, të “Kontratës individuale të punës”, nenit 44, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet Administrative”, i rekomandojmë Kryetarit të Komunës Berxull, që bazuar në nenin 44, të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, të fillojë procedurat për dhënien e masës “Zgjidhje të kontratës së punës” për 2 punonjësit si më poshtë:**

**1- zj. V.Sh.** me detyrë Përgjegjëse e Zyrës së Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës, pasi:

Nuk disponohen aktet të mënyrës dhe ndarjes së tokës në pronësi si më poshtë:

Një regjistër të tokës bujqësore (tokën bujqësore të ndarë, numrin e familjeve bujqësore përfituese, sipërfaqen e përfitimit, zërin kadastral të saj etj.)

Kopjen origjinale apo një kopje të njësuar me origjinalin të formularit nr. 6

Kopjen origjinale apo një kopje të njësuar me origjinalin të Regjistrave kadastral të tokës bujqësore të vitit 1991 apo 1992.

Kopje origjinale apo një kopje të njësuar me origjinalin të hartave kadastrale të shërbyer për procesin e ndarjes së tokës.

Kopje origjinale apo një kopje të njësuar me origjinalin të librave të ngastrave.

Kopjen origjinale apo një kopje të njësuar me origjinalin të Hartave Treguese të Regjistrimit të ZVRPP.

Nuk ka një regjistër ku të evidentohet nëse përfituesi ka marrë tokës si punonjësi i ndërmarrjes bujqësore, bashkëthemelues i saj apo si banorë i komunës, pasi edhe pse norma për frymë rezulton se ka qenë 1700 dhe 1000-1200 për Berxull dhe Domje.

Nuk është proceduar me hartimin e një relacioni ku të evidentohet çdo e dhënë mbi pasurinë e dërguar për konfirmim në ZVRPP apo DAMT, por janë kufizuar me përshkrimin se çfarë ka të përfutuar përfaqësuesi i familjes bujqësore dhe se kjo pronë nuk ka asnjë konflikt pronësie në terren apo pretendime nga të tretë.

Nuk saktësohet ndryshimi i parcelës të përcaktuar në AMTP me atë të dërguar për regjistrim në ZVRPP apo për konfirmim në DAMT, duke u kufizuar në shprehjen “sipas planit të rilevimit dhe azhurnimit faktik në terren”.

Janë dërguar për regjistrim apo konfirmim praktika të cilat rezultojnë me korrigjime në sipërfaqe, numër pasurie apo dhe kufitarë.

Nuk është vepruar me konfirmimin nëse kufijtë apo kufitarët sipas AMTP janë të njëjtë me ato sipas regjistrimit të pasurive në ZVRPP, apo me kufitarët po sipas AMTP kufitare

Në një rast është dërguar për konfirmim AMTP nr. 590, datë 09.10.1995, e nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe ish-Përgjegjësja e ZMMT të Komunës (Praktika nr. 433, datë 15.6.2012) por nuk është dokumentuar procedura sipas *ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008*.

Në një rast është dërguar për konfirmim në DAMT praktika me nr. 152, datë 18.02.2011, dhe nr. 17, datë 11.01.2012 e përfaqësuesit të familjes bujqësore R. D. për sipërfaqen prej 4000 m<sup>2</sup>, e cila sipas AMTP është “kullotë”, pra nuk është objekt përfitimi nga ligji nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, i ndryshuar.

Në një rast është dërguar në ZVRPP Tiranë me shkresën nr. 730, datë 30.10.2013, praktika për AMTP nr. 8, datë 11.9.1995, Domje, kur rezulton se më datë 01.10.1992 ka qenë i regjistruar në regjistrin e gjendjes civile të Komunës Kashar.

Në një rast është dërguar për regjistrim në ZVRPP Tiranë me shkresën nr. 801, datë 19.11.2013, praktika për AMTP nr. ska, datë ska, Berxull, kur rezulton se nuk ka emërin e mbiemrin e as nuk është nënshkruar nga Kryetari i Komisionit të Tokës në fshat.

Në një rast është dërguar për konfirmim në DMMT me shkresën nr. 312, datë 07.05.2012, praktika për AMTP nr. 34, datë 12.9.1995, Domje, kur rezulton se nuk është nënshkruar nga Kryetari i Komisionit të Tokës në fshat.

**2- P.J.** me detyrë Kryeinspektor i INUV-it, nga data 01.08.2011 deri me datë 30.06.2014 e në vazhdim, *pasi*:

- Nuk është zbatuar masa administrative “vendim me gjobë” për 10 raste të ndërtimit të objekteve pa leje, veprim në kundërshtim me germën “a”, të nenit 5, të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2011 “Për Inspektimin e ndërtimit”, i ndryshuar.

- Nuk është zbatuar masa “prishje të objektit të kundërligjshëm” për 10 raste të ndërtimit të objekteve pa leje, veprim në kundërshtim me germën “d”, të nenit 5, të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2011 “Për Inspektimin e ndërtimit”, i ndryshuar.

- Janë konstatuar të ndërtime të paligjshme dhe në asnjë rast nuk ka përgatitur kallëzim penal, për ta paraqitur pranë organeve përkatëse, veprim në kundërshtim me germën “dh”, të nenit 5, të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2011 “Për Inspektimin e ndërtimit”, i ndryshuar.

-Nuk janë ndjekur procedurat e plota ligjore për vjeljen e gjobave, për rrjedhojë arkëtimi i tyre rezulton të jetë në nivele të ulëta, veprim në kundërshtim me nenin 16, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar dhe me nenin 22, me pikën 4/a të nenit 30, të ligjit nr. 10279 “Për Kundërvajtjet Administrative”.

- Në kontrollet e ushtruara, nuk përpilohet dokumentacioni përkatës, ku pasqyrohet gjendja dhe problemet e konstatuara, kjo në kundërshtim me nenin 12, të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2011 “Për Inspektimin e ndërtimit”, i ndryshuar dhe me pikën 4, të VKM nr. 862, datë 05.12.2007 “Për Unifikimin e Procedurave të Kontrollit të Territorit nga Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar e ai Vendor”.

- Nuk janë ushtruar kontrolle, për disa objekte, në drejtim të zbatimit të lejeve të ndërtimit të dhëna nga urbanistika në periudhën e vitit 2011, duke mos kontrolluar zbatimin e punimeve të ndërtimit, është lejuar që në katër raste të kryhen punime pa u vendosur mbikëqyrësi, veprim në kundërshtim me germën “a”, të nenit 5 të ligjit nr.

9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin” dhe me pikën 1, paragrafi (iii), të VKM nr. 862, datë 05.12.2007 “Për Unifikimin e Procedurave të Kontrollit të Territorit nga Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar e ai Vendor” dhe në kundërshtim me nenin 7, ligji 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, në kundërshtim me, pikën 4, të udhëzimit nr. 3, datë 15.02.2001 “Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar me udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011.

- Janë nxjerrë akte administrative “vendim me gjobë”, por nuk janë shoqëruar me procesverbalin e konstatimit të kundërvajtjes, duke rrisur shfuqizimin e aktit administrativ, siç ka ndodhur për një rast, veprim në kundërshtim me germën “b”, pika 1 dhe pika 2, të nenit 13, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative”.

***C.II. Mbështetur në nenin 37 dhe 154 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës”, të ndryshuar dhe të “Kontratës individuale të punës”, i rekomandojmë Kryetarit të Komunës Berxull, që bazuar në nenin 44 të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje me shkrim” për 13 punonjësit si më poshtë:***

**1 – Z.V.** me detyrën Përgjegjëse e Zyrës së Financës, për periudhën nëntor 2011 deri me 30.06.2014, pasi;

- nuk janë përcaktuar Objektivat, Misioni dhe Vizioni i Njesisë, Deklarata e misionit vizionit nuk është bërë e njohur nga punonjësit, pohim ky i vërtetuar nga përgjigja e pyetjes nr. 1 të pyetësorit, së cilës i mungojnë përcaktimet dhe komenti. Mungojnë plani strategjik i zhvillimit afat mesëm e afatgjatë; plani i veprimit afat shkurtër dhe objektivat lidhur me strategjitë zhvillimore dhe prioritetet e këtij institucioni, nuk ka specifikime e përcaktime për titujt dhe datat e miratimit të tyre, veprim në mospërbushje të neneve 17 dhe 29, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe nenit 18 të ligjit 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar”.

- nuk ka dërguar për miratim në këshillin e komunës realizimin faktik të buxhetit vendor për vitin 2011, 2012, 2013, 2014, veprim në kundërshtim me nenin 32 dhe 33, të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin e funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar.

- janë paguar shpenzime transporti për muajin dhjetor 2013, janar dhe shkurt të vitit 2014, për Kryetarin e Komunës në shumën 60,000 lekë, në kundërshtim me pikën 2, të ligjit nr. 169/2013, datë 07.11.2013 “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë”.

- janë pajisur me numër telefoni celulari duke kryer pagesën nga llogaria e shpenzimeve operative të buxhetit të komunës, për 11 punonjës të administratës në shumën 138,464 lekë, në kundërshtim me pikën 11, lidhja nr. 6, të VKM nr. 864, datë 23.07.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridik, publik”,

- nuk ka regjistruar në librat e kontabilitetit dhe në pasqyrat financiare të vitit 2011, 2012, 2013, familjet debitor të fshatit Domje dhe Berxull, të cilat nuk kanë paguar ujin e pijshëm në shumën 3,540,336 lekë, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 24.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare”, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, VKM nr. 783, datë



22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël” dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”,

**2 – Sh.B.** me detyrën detyrë ish-Administratore nga data 01.07.2011 deri me datë 19.09.2011, specialiste e pagash dhe e Burimeve Njerzore, për periudhën shtator 2011 deri me 30.06.2014, *pasi*;

-nuk ka dërguar për miratim në këshillin e komunës strukturën e administratës për vitin 2014, veprim në kundërshtim me nenin 32 e 54, të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”.

- në 3 raste nuk janë zbatuar kërkesat e VKM nr. 1619, datë 02.07.2008 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore”, të ndryshuar, duke përfituar padrejtësisht Sh.M., shumën 26,000 lekë, P.J., 63,725 lekë dhe B.M., 67,188 lekë.

- janë paguar anëtarët e këshilli të komunës për mospjesëmarrje në mbledhje të këshillit për muajin maj-qershor të vitit 2011, në shumën 180,180 lekë, veprim në kundërshtim me pikën 16, të VKM nr. 1619, datë 2.7.2008“Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njërive të qeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore”, të ndryshuar.

- nuk është mbajtur ditari i magazinës duke mos pasqyruar veprimet që lidhen me dokumentimin e lëvizjen e aktiveve, me pasqyrimin e detyrimeve debitor, ngjarje që lidhen me dokumentimin dhe lëvizjen e aktiveve sidomos me hyrjet e materialeve dhe të inventarit, daljet nga nxjerrjet jashtë përdorimit, që ka krijuar mangësi që bilancet nuk pasqyrojnë gjendjen reale dhe të besueshme të pasurisë së komunës.

- komisioni i inventarizimit, para fillimit të inventarit, nuk ka mbajtur një procesverbal midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit, për të fiksuar numrin rendor të fletëhyrjes dhe fletëdaljes, veprim në kundërshtim me pikën 83, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

**3-D.K.** me detyrë ish-Administratore e ndihmës ekonomike nga data 19.09.2011 deri me datë 01.02.2012,e në vazhdim në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, për tenderin e zhvilluar me objekt “Ndërtim e Sistemim i Rrugës së Kastratëve”, *pasi*;

- nuk janë përcaktuar Objektivat, Misioni dhe Vizioni i Njesisë, Deklarata e misionit vizionit nuk është bërë e njohur nga punonjësit, pohim ky i vërtetuar nga përgjigja e pyetjes nr. 1 të pyetësorit, së cilës i mungojnë përcaktimet dhe komenti. Mungojnë plani strategjik i zhvillimit afat mesëm e afatgjatë; plani i veprimit afat shkurtër dhe objektivat lidhur me strategjitë zhvillimore dhe prioritetet e këtij institucioni, nuk ka specifikime e përcaktime për titujt dhe datat e miratimit të tyre, veprim në mospërbushje të neneve 17 dhe 29, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe nenit 18 të ligjit 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar”.

-në të gjitha rastet dosjet e ndihmës ekonomike dhe të personave që trajtohen me pagesë paaftësie janë pa inventarizuar; për vitin 2011 deri me 30.06.2014, në të gjitha rastet deklarata model 2, nuk është plotësuar nga të gjithë personat madhor; për vitin 2011 deri me 30.06.2014, në të gjitha rastet nuk janë llogaritur të ardhurat nga blegtoaria; në të gjitha rastet mungon certifikata e pronësisë, lëshuar nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, si dhe Akti i Marrjes në Pronësi ose në Përdorim të Tokës; në të gjitha rastet mungon vërtetimin si punëkërkuar të papunë,

për të gjithë anëtarët e familjes, të aftë për punë, që aplikojnë për ndihmë ekonomike, lëshuara nga zyra e punës.

**4 - F.P.** me detyrë Përgjegjës i Zyrës së PKZHT-së, nga data 01.01.2014, e në vazhdim, *pasi*:

- Nuk është ushtruar kontroll i vazhdueshëm, për të vëzhguar zhvillimin e territorit, për të parandaluar rreziqet e zhvillimeve të dëmshme dhe për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm të territorit, veprim në kundërshtim me pikën 1, neni 80, të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009, “Për Planifikimin e Territorit”, i ndryshuar.

-Nuk është hartuar një regjistër, ku botohen të gjithë projekt aktet dhe aktet e miratuara që sjellin zhvillimin e territorit, veprim në kundërshtim me pikën 4, neni 53, të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”, i ndryshuar.

**5 – N.B.** me detyrë specialist i Zyrës së PKZHT dhe në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, për tenderin e zhvilluar me objekt “Ndërtim e Sistemit i Rrugës së Kastratëve”, *pasi*:

-Nuk është përcaktuar saktë vlera e preventivit të prokuruar, për objektin “Ndërtim e Sistemit i Rrugës së Kastratëve”, duke rritur në mënyrë fiktive fondin limit, në vlerën 6,633,455 lekë(pa TVSh), por pa efekt ekonomik, veprim në kundërshtim me, pikën 1, të nenit 28, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, me germën “a”, pika 2, kreu II, V.K.M. nr. 1, datë 10.01.2007 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me pikën 12, VKM nr. 514, datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”

**6 - V.Sh.** me detyrë anëtare i komisionit të inventarizimit për vitin 2013, *pasi*:

- komisioni i inventarizimit para fillimit të inventarit nuk ka mbajtur një procesverbal midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit për të fiksuar numrin rendor të fletëhyrjes dhe fletëdaljes, veprim në kundërshtim me pikën 83, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

**7- A.K.** me detyrë specialist i Zyrës së Tatim Taksave Vendore për periudhën 08.07.2011 e vazhdim (pas datës 01.07.2013 si përgjegjës) *dhe*

**8 – B.M.** me detyrë specialist i Zyrës së Tatim Taksave Vendore për periudhën 02.11.2012 e vazhdim, *pasi*:

*Për Taksën e Ndërtesës* vendosja e ngarkesës për abonentët familjarë dhe jo familjarë (subjekte private) është bërë mbi bazën e vetë deklarimeve të subjekteve dhe jo të gen planeve ose të dhënave të ZVRPP, apo të Zyrës Urbanistike mbi sipërfaqe e objekteve për të cilat miratohen lejet e ndërtimit të objekteve.

*Për Taksën e Regjistrimit të Automjeteve* nuk disponohej (*akt-rakordim*), mbi gjendjen e inventarit dhe numrin e mjeteve, ku të evidentohej; numri i mjeteve në përdorim, numri i mjeteve jashtë përdorimit, numri i mjeteve që paguaj dhe jo, të dhëna të cilat dalin sipas akt rakordimit me DSHT Tiranë, sa nga këto janë jashtë përdorimit dhe sa janë në aktivitet, gjendje e cila del sipas një akt rakordimi me DSHT Tiranë.

*Për Taksën e zënies së hapësirave publike*, nuk ka një regjistër mbi subjektet që i posedojnë këto hapësira dhe se sa është sipërfaqja që ato zotërojnë.

*Për Tarifën e Pastrimit* rezulton se nga viti në vit paraqitet me mos realizim dhe detyrimi ligjor për pagimin dhe arkëtimin e kësaj tarife aplikohet vetëm për abonentët familjarë që paraqiteshin në komunë për kryerjen e shërbimeve të ndryshme, duke bërë që nga ZTTV të mos evidentohet në mënyrë të saktë sa është detyrimi që lind nga kjo tarifë, vlera e detyrimit të arkëtuar dhe të mbetur, ndarë ky në vite.

*Për Taksën mbi Ndërtimet e Reja dhe Ndikimet në Infrastrukturës*, nuk ka akt-rakordim me Zyrën Urbanistike mbi lejet e ndërtimit dhe përdorimit, nivelin e taksës që detyrohet të paguajnë, pagesat e kryera, si dhe pritshmërinë e kësaj takse të dhëna këto të cilat shërbejnë dhe për planifikimin e saktë të ardhurave nga këto zëra dhe arkëtimin e vlerave të mbetura, pasi dhe nga të dhënat konstatohet tejkalime të të ardhurave në nivele të lartë, që do të thotë se planifikimi nuk është i saktë.

*Për pagesën e Taksave të Biznesit të Vogël (TBV)*, rezulton se nga 6 subjekte aktiv nuk janë taksuar për detyrimin e taksës dhe tarifës vendore për vitin 2013, me vlerë 159,200 lekë, dëm ekonomik në të ardhurat e munguara në buxhetin e komunës.

**9 – M.Sh.** me detyrë Përgjegjëse e Zyrës Juridike, për periudhën nëntor 2011 e në vazhdim, *pasi*;

- nuk ka dërguar për miratim në këshillin e komunës realizimin faktik të buxhetit vendor për vitet 2011, 2012, 2013, 2014, veprim në kundërshtim me neni 32 dhe 33, të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin e funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar.

-nuk ka dërguar për miratim në këshillin e komunës strukturën e administratës për vitin 2014, veprim në kundërshtim me nenin 32 e 54, të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”.

- në 3 raste nuk janë zbatuar kërkesat e VKM nr. 1619, datë 02.07.2008 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore”, të ndryshuar, duke përfutur padrejtësisht Shaqir Marku, shumën 26,000 lekë, Petrit Jani, 63,725 lekë dhe Bajram Mici, 67,188 lekë. (*Trajtuar në pikën 5, faqe 37-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

- janë pajisur me numër telefoni celulari duke kryer pagesën nga llogaria e shpenzimeve operative të buxhetit të komunës për 11 punonjës të administratës në shumën **138,464 lekë**, në kundërshtim me pikën 11, Lidhja nr. 6, të VKM nr. 864, datë 23.07.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridik, publik”.

**10- D.P.** me detyrë ish-Administratore e ndihmës ekonomike nga data 01.02.2012, deri me 01.08.2013, aktualisht punonjëse në zyrën e shërbimeve *pasi*;

-në të gjitha rastet dosjet e ndihmës ekonomike dhe të personave që trajtohen me pagesë paaftësie janë pa inventarizuar; për vitin 2011 deri me 30.06.2014, në të gjitha rastet deklarata model 2, nuk është plotësuar nga të gjithë personat madhor; për vitin 2011 deri me 30.06.2014, në të gjitha rastet nuk janë llogaritur të ardhurat nga blegtoria; në të gjitha rastet mungon certifikata e pronësisë, lëshuar nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, si dhe Akti i Marrjes në Pronësi ose në Përdorim të Tokës; në të gjitha rastet mungon vërtetimin si punëkërkuar të papunë, për të gjithë anëtarët e familjes, të aftë për punë, që aplikojnë për ndihmë ekonomike, lëshuara nga zyra e punës.

- Në inventarin për zyrat, shkollat dhe kopshtet e komunës, komisioni i inventarizimit nuk ka plotësuar kolonat “Të dhënat e inventarizimit”, si dhe fletët e inventarit nuk janë nënshkruar nga anëtarët e komisionit dhe nga personat përgjegjës, ndërsa

materialet e nxjerra jashtë përdorimit në vlerën 3,026,669 lekë, nuk janë bërë hyrje në magazinë. Në përmbledhësen e inventarit të vitit 2012, nuk është pasqyruar vlera e ndërtesave si: zyrat e komunës, shkollat dhe kopshte. Gjatë procesit të inventarizimit nuk janë nxjerrë materiale jashtë përdorimit.

- komisioni i inventarizimit para fillimit të inventarit nuk ka mbajtur një procesverbal midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit, për të fiksuar numrin rendor të fletëhyrjes dhe fletëdaljes, veprim në kundërshtim me pikën 83, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

**11 – Xh.M.** me detyrë Administratore nga data 01.08.2013 e në vazhdim, *pasi*:

-në të gjitha rastet dosjet e ndihmës ekonomike dhe të personave që trajtohen me pagesë paafësie janë pa inventarizuar për vitin 2011 deri me 30.06.2014, në të gjitha rastet deklarata model 2, nuk është plotësuar nga të gjithë personat madhor për vitin 2011 deri me 30.06.2014, në të gjitha rastet nuk janë llogaritur të ardhurat nga blegtoria, në të gjitha rastet mungon certifikata e pronësisë, lëshuar nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, si dhe Akti i Marrjes në Pronësi ose në Përdorim të Tokës, në të gjitha rastet mungon vërtetimi i lëshuar nga zyra e punës si punëkërkues të papunë, për të gjithë anëtarët e familjes të aftë për punë, që aplikojnë për ndihmë ekonomike.

**12- G.M.**, me detyrë inspektor i INUV-it, nga data 01.08.2011, e në vazhdim, *pasi*:

- Nuk ka ushtruar kontrolle në vazhdimësi në territorin e Komunës, për rrjedhojë nuk janë përpiluar aktet përkatëse dhe nuk ka dokumentacion të mjaftueshëm, që të pasqyrojë aktivitetin e kryer, **veprime në kundërshtim me nenin 4**, të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2011 “Për Inspektimin e ndërtimit”, i ndryshuar dhe me pikën 6 “Detyrat Funksionale të Inspektorit të INUV-it”, të Rregullores “Për Organizimin, Funksionimin, Detyrat dhe Kompetencat e Administratës së Komunës Berxull”.

**13- K.B.** me detyrë Specialist i ZMMT, *pasi*:

Nuk është proceduar me hartimin e një relacioni ku të evidentohet çdo e dhënë mbi pasurinë, e dërguar për konfirmim në ZVRPP apo DAMT, por janë kufizuar me përshkrimin se çfarë ka të përfutur përfaqësuesi i familjes bujqësore dhe se kjo pronë nuk ka asnjë konflikt pronësie në terren apo pretendime nga të tretë.

Nuk saktësohet ndryshimi i parcelës të përcaktuar në AMTP, me atë të dërguar për regjistrim në ZVRPP apo për konfirmim në DAMT, duke u kufizuar në shprehjen “*sipas planit të rilevimit dhe azhurnimit faktik në terren*”.

Janë dërguar për regjistrim apo konfirmim praktika të cilat rezultojnë me korrigjime në sipërfaqe, numër pasurie apo dhe kufitarë.

Nuk është vepruar me konfirmimin nëse kufijtë apo kufitarët sipas AMTP janë të njëjtë me ato sipas regjistrimit të pasurive në ZVRPP, apo me kufitarët po sipas AMTP kufitare

*Në një rast* është dërguar për konfirmim në DAMT praktika me nr. 152, datë 18.02.2011, dhe nr. 17, datë 11.01.2012 për sipërfaqen prej 4000 m<sup>2</sup> e cila sipas AMTP është “kullotë”, pra nuk është objekt përfitimi nga ligji nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, i ndryshuar.

*Në një rast* është dërguar në ZVRPP Tiranë, me shkresën nr. 730, datë 30.10.2013, praktika për AMTP nr. 8, datë 11.9.1995, Domje, kur rezulton se më datë 01.10.1992 ka qenë i regjistruar në regjistrin e gjendjes civile të Komunës Kashar.

Në një rast është dërguar për regjistrim në ZVRPP Tiranë, me shkresën nr. 801, datë 19.11.2013, praktika për AMTP (pa numër dhe pa datë) Berxull, kur rezulton se nuk ka emërin e mbiemrin e as nuk është nënshkruar nga Kryetari i Komisionit të Tokës në fshat.

Në një rast është dërguar për konfirmim në DMMT me shkresën nr. 312, datë 07.05.2012, praktika për AMTP nr. 34, datë 12.9.1995, Domje, kur rezulton se nuk është nënshkruar nga Kryetari i Komisionit të Tokës në fshat.

#### **D. MASA ADMINISTRATIVE**

Mbështetur në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, në pikën 1, të nenit 15, të ligjit 8402, datë 10.09.21998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar me ligjin nr. 20/13, datë 14.02.2013, që për shkelje të ligjshmërisë në mbikëqyrjen e zbatimit të punimeve të ndërtimit, ti propozojë INUV-it, Komuna Berxull, të vendosë sanksionet si më poshtë:

**Dënimin kryesorë me gjobë, në vlerën 50 000 lekë, të mbikëqyrësit të punimeve të ndërtimit, respektivisht:**

**1. Subjekti “S...T...”sh.p.k.**, përfaqësuar nga ing. S.M., (licenca nr. MK 1642), me të cilin është lidhur kontrata e shërbimit me datë 01.08.2011, për mbikëqyrjen e zbatimit të punimeve të ndërtimit për rikonstruksionin e “Rrugës së Kastratëve, Komuna Berxull”, për shkak se:

a-Mungojnë provat laboratorike për materialet mbushëse, shtresë zhavorri(t=30 cm) dhe të shtresave të çakllit(t=20 cm), sipas kërkesave të specifikimeve teknike dhe bazuar në standardet shqiptare, mungojnë provat dhe raportet e testimit për materialin e shtresave të stabilizantit dhe provat për përcaktimin e trashësisë së shtresave asfaltike (karrotazhi).

b-Punimet e ndërtimit nuk janë zbatuar në përputhje me kushtet teknike të projektimit e të zbatimit dhe librezat e masave për përshkrimin e punimeve sipas grafikut dhe projekt zbatimit, nuk pasqyrojnë me vërtetësi punimet e kryera për të përcaktuar saktë volumet e punimeve. Si rezultat i situacionimit për dy zëra punimesh, me diferenca volumesh të pa kryera në vlerën **221,400 lekë**, ka krijuar mundësinë e përfitimit të pa drejtë nga operatori ekonomik “A... Konstruksion”.

Në kundërshtim me nenin 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001”Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit”, të ndryshuar.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

*Shënim:* Auditimi është kryer nga audituesit Luan Kuka, Ryisim Xhaja dhe Qemal Shehu, më tej u shqyrtua nga z. Niko Nako kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve, si dhe u verifikua si praktikë nga znj. Luljeta Nano, Sekretar i Përgjithshëm.

